

22 Maj 2017

Kumtesë për Shtyp

Ambasadat e ASuedisë, Holandës dhe Zvicrës, SPARK dhe IBCM kanë nxjerrë sot një kumtesë të përbashkët për shtyp në lidhje me Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë / IBCM:

Njoftimi i mbylljes së menjëhershme të Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM)

Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit Mitrovicë (IBCM) do të detyrohet të mbyllë aktivitetet e tij, vendim ky që hyn në fuqi në korrik të vitit 2017, mbas përfundimit të vitit akademik, nëse Qeveria e Kosovës nuk i mban premtimet e veta që prej kohësh për të marrë përsipër shpenzimet operationale të IBCM-it nga donatorët ndërkombëtarë.

Mbyllja do të ketë një ndikim negativ tek studentët (200), stafi (35), familjet dhe komuniteti në rajonin e Mitrovicës. Për më tepër, do të vënë në pikëpyetje angazhimin e Qeverisë së Kosovës në promovimin e arsimit dhe shkëmbimit midis komuniteteve në këtë rajon kompleks.

Kërkesë urgjente për Qeverinë e Kosovës:

Donatorët ndërkombëtarë, IBCM dhe SPARK, i bëjnë thirrje Qeverisë së Kosovës, veçanërisht Kryeministrit, Ministrin të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Presidentit të Kosovës që:

1. Urgjentisht të vendosin për fond emergjent për IBCM-in dhe të lirojnë menjëherë të paktën vitin e parë të financimit, prej 600.000 euro, në përputhje me marrëveshjen ndërkombëtare të nënshkruar. Vetëm kështu mund të shmanget mbyllja.
2. Të punohet me Qeverinë dhe Kuvendin e ardhshëm të Kosovës që sa më shpejt të ratifikojnë marrëveshjen ndërkombëtare të aprovuar më herët, që të sigurojnë qëndrueshmëri afatgjate të IBCM dhe që t'ia mundësojnë kolegjit të funksionojë si një institucion i arsimit të lartë jo-fitimprurës nën licencën nga MASHT dhe Akreditimin nga Evalag nga Gjermania dhe Agjencia e Akreditimit të Kosovës.

Në mungesë të një vendimi pozitiv nga Qeveria e Kosovës për fonde emergjente për IBCM, Kolegji do të mbyllet në korrik 2017.

Gjendja momentale:

- Kontributet e donatorëve në IBCM kanë mbaruar, nuk do të riaktivizohen, dhe IBCM është jashtë buxhetit.
- Qeveria e Kosovës duhet të ketë filluar financimin e IBCM nga 1 janari 2017. Qeveria ka rezervuar 3 milion euro në buxhetin e saj 2017 dhe ka miratuar një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit / MASHT dhe SPARK (si menaxher i përkohshëm). Marrëveshja u nënshkrua nga Ministri i Arsimit dhe nga SPARK më 12 prill 2017. Në marrëveshjen thuhet qartë se SPARK do t'ia transferojë përgjegjësitë e tij sa më shpejtë që të jetë e mundur IBCM-it, duke e bërë IBCM-in një institucion të pavarur jo-fitimprurës;
- Marrëveshja ndërkombëtare priste ratifikimin nga Kuvendi i Kosovës, i cili u shpërbë, për shkak të një votë mosbesimi, duke e bërë kështu ratifikimin teknikisht të pamundur.
- Për të mbajtur funksionimin e IBCM dhe duke pritur fondet e Qeverisë që është dashur të depozitohen më së largu më 1 janar 2017, SPARK ka përdorur 0.2 milion euro të buxhetit të tij. Kjo nuk mund të vazhdojë.

Nënshkruar nga: Ambasadat e Suedisë, Holandës, Zvicrës, SPARK dhe IBCM.

Kontakt: SPARK / email: press@spark-online.org

Historik i shkurtër

Qeveria e Kosovës në vitin 2008 vendosi të hapë një kolegji ndërkombëtar biznesi (IBCM) në Mitrovicë dhe paraqiti iniciativën e saj në konferencën ndërkombëtare të donatorëve në Bruksel. Për shkak të mjedisit kompleks në Mitrovicë, Qeveria e Kosovës kërkoi mbështetje ndërkombëtare për të realizuar iniciativën e saj ambicioze. Qeveria ofroi 1.5 milion euro për punimet e ndërtimit të kampusit në jug të Mitrovicës dhe siguroi një premtim të shkruar për donatorët ndërkombëtarë për shpenzimet e ardhshme operationale. Ajo kërkoi që organizata ndërkombëtare SPARK të menaxhojë IBCM-in në një bazë të përkohshme, deri në momentin që të bëhet një kolegji i pavarur ndërkombëtar jo-fitimprurës.

Pas kësaj kërkesë dhe duke marrë parasysh kontributin financiar të Qeverisë, donatorët ndërkombëtarë, si Suedia, Danimarka, Holanda, Bashkimi Evropian, Zvicra kanë siguruar gjithsej 13.5 milionë euro kontribute deri më 1 janar 2017.

Dy ndërtesa të mëdha të kampuseve janë ndërtuar dhe janë në përdorim. Është siguruar kreditimi ndërkombëtar i diplomave (nga Gjermania dhe Danimarka) mbi akreditimin dhe licencën lokale të Kosovës nga MASHT.

Kolegji ka 200 studentë. Më shumë se 80% e të diplomuarve gjejnë punë brenda 6 muajve pas diplomimit. Shumë të diplomuar të pakicave tani mbajnë pozita të larta në administratën e Kosovës. Numri i pranimit të studentëve është rritur 30% në vitin e kaluar dhe regjistrimet e reja janë rritur edhe këtë vit.

Që nga vera e vitit 2015, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka punuar për të jetësuar premtimin për të mbuluar kostot operationale. Për shkak të shumë vonesave në këtë proces, deri më tani nuk ka fonde të lëshuara nga Qeveria. Kjo pavarësisht nga më shumë se një vit të përpjekjeve intensive të bashkësisë ndërkombëtare të donatorëve për të punuar me qeverinë (deri në nivelin e Presidentit) për të zbatuar marrëveshjen.

